

**PROCEDURA E MARRJES DHE E SHQYRTIMIT TË KOMENTEVE DHE  
REKOMANDIMEVE BAZUAR NE RREGULLOREN PER KONSULTIMET  
PUBLIKE ESHTË SI ME POSHTE:**

**Dokumentimi dhe shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve të bashkësisë**

1. Komentet dhe rekomandimet e bashkësisë të shprehura në takimet publike të organizuara nga Këshilli në kuadër të këshillimit publik, dokumentohen në procesverbalin e takimit publik. Procesverbali mbahet nga Sekretari apo një punonjësi Sekretariatit të Këshillit, të autorizuar nga Sekretari.
2. Sekretari përgatit një përmbledhje të rekomandimeve të takimeve publike, dokumenti i cili bashkëfirmoset nga drejtuesi i takimit.
3. Sekretari i dërgon Kryetarit të Bashkisë një kopje të përmbledhjes së rekomandimeve.
4. Projektakti që i paraqitet për shqyrtim Komisionit të Përhershëm shoqërohet me përmbledhjen e rekomandimeve të pranuar ngatakimeve publike, ndërkohë përmbledhja e rekomandimeve të pranuar nga seancat dëgjimore në Komisioneve të Përhershme, sëbashku me rekomandimet e pranuar nga takimeve publike, shoqërojnë projektaktin dhe i paraqitet për shqyrtim Mbledhjes së Këshillit. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë Këshilli/ Komisioni i të Përhershëm paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre e cila i bashkëngjiten projektaktit që shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit.
5. Komentet dhe rekomandimet e bashkësisë, që i dërgohen Këshillit me postë elektronike apo shkresë, përmbledhen nga Sekretari në bashkëpunim me punonjësit e Sekretariatit, në një dokument relacion të cilin Kryetari i Këshillit, nëpërmjet Sekretariatit dërgon me shkresë Kryetarit të Komisionit përkatës, si dhe çdo Këshilltari në postën elektronike.

**Standartet e reagimit të Këshillit ndaj komenteve dhe rekomandimeve të publikut**

1. Këshilli siguron reagim ndaj komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve të dërguara nga publikut apo grupet e interesit për projektaktin/ projektpolitikën e shpallur për këshillim publik, përgjatë gjithë fazave të procesit të këshillimit publik.
2. Në varësi të numrit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve, Këshilli, nëpërmjet Sekretarit, i dërgon konfirmimin e marrjes së tyre të gjithë dërguesve:
  - a. me poste elektronike (individualisht), ose
  - b. përgjigje kolektive (me poste elektronike apo në portalin e këshillimit të Këshillit; nëse postohen në portal komente apo rekomandime nga palët që kanë kontribuar, brenda 15 ditëve pune nga postimi i përgjigjes kolektive, kjo do të konsiderohet si konfirmimi i marrjes së reagimit të Këshillit nga kontribuesi).